



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 113/2 prot

Datë 19.01.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91784-12-20-2023, me objekt: “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024”, me fond limit 9 015 678 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Nelsa” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Argent Daci” P.f me NIPT L01914003T dhe adresë: Tiranë, Kamëz, Godina Nr.21, poshtë kthesës së Valiasit

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “MC Catering” SHPK me NIPT K72218022J dhe adresë: Tirane Tirane Tirane, , Rruga "Pjeter Budi", Nd.29, H3, Ap.14, Njesia Administrative nr.2, 1010

Operatori ekonomik “4 S” SHPK me NIPT L64425401K dhe adresë: Lushnje Fier, Lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4

Operatori ekonomik “Nelsa” SHPK me NIPT J71601012S dhe adresë: Dajt Tirane Dajt, DAJT, Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1

Në datën 18.01.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr.113 prot.,e operatorit ekonomik “Argent Daci” P.F, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-91784-12-20-2023, me objekt: “Blerje mish për kafshët e Kopshtit Zoologjik për vitin 2024”, me fond limit 9 015 678 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “MC Catering” SHPK, “4 S” SHPK dhe “Nelsa” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “Argent Daci” P.F me anë të ankesës me nr. 113 protokollit, datë 18.01.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “MC Catering” SHPK, “4 S” SHPK dhe “Nelsa” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorëve ekonomikë “MC Catering” SHPK, “4 S” SHPK dhe “Nelsa” SHPK të kriterit si më poshtë:

2.1.1 *Operatori ekonomik te paraqesë licencen Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:*

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A. “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”,

Licenca duhet të jetë në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurë pasi duhet ti përkasë operatorit të interesuar të ofertojë për procedurën e prokurimit të shpallur nga Autoriteti Kontraktor.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve duhet të ketë Licensën, Nënkatëgoria: II.1.A

(Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nënligjore)."

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 19.01.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetari
Jonaid Myzyri